



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	156 / 16
Nr. i fq. / Br. st	- 6 -
Data: / Datum	28. 07. 2016
VUSHTRRI - VUČITRN	



KUVENDI I KOMUNËS – VUSHTRRI

**RREGULLORE (KKV) NR.03/16
PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT,
VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË
VUSHTRISË**

Qershor, 2016

Në bazë të nenit 11, 12, paragrafi 2, pika (c) dhe nenit 34, paragrafi 4 i Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (GZ Nr. 28/2008, 04 qershor 2008), Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr. 2008/08 për Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, nenit 9 dhe 10 të Statutit Nr.58/11 dt.28.04.2011 të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **28 korrik 2016**, miratoi këtë:

**RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME
FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE
NË TERRITORIN E KOMUNËS SË VUSHTRRISË**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës së Vushtrrisë me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e saj, duke përfshirë zgjedhjen e këshillave, kompetencat dhe përgjegjësitë e këshillave, në ushtrimin e aktiviteteve që janë në kompetencë të komunës.

**Neni 2
Zgjedhja e këshillave lokale**

- 2.1. Komuna e Vushtrrisë zgjedh këshillat dhe kryetarin e këshillit në fshatra, vendbanime apo lagje urbane, për të realizuar sa më mirë funksionet e parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës dhe rregulloret komunale.
- 2.2. Në fshatrat ku numri i banorëve është i vogël, zgjedhet këshilli i përbashkët në tubimin e përbashkët me këtë mënyrë përfaqësimi:
 - 2.2.1. Këshilli i fshatit Skromë – 3 anëtarë, ku përfshihen edhe këto fshatra: Gumnishtë, Boshlan, Kurillovë dhe Vesekoc me nga 1 anëtar.
 - 2.2.2. Këshilli i fshatit Karaçë – 3 anëtarë, ku përfshihen edhe fshatrat: Shlivovicë dhe Miraçë me nga 1 anëtar.
 - 2.2.3. Këshilli i fshatit Samadarexhë – 6 anëtarë, ku përfshihet edhe fshati Zagorë me 1 anëtar.
 - 2.2.4. Këshilli i fshatit Ceceli - 6 anëtarë, ku përfshihet edhe fshati Kunovik me 1 anëtar.
 - 2.2.5. Këshilli i fshatit Studime e Epërme – 6 anëtarë, ku përfshihet edhe fshati Skoçan me 1 anëtar.
 - 2.2.6. Këshilli i fshatit Bukosh - 4 anëtarë, ku përfshihet edhe fshati Taraxhë me 1 anëtar.
- 2.3. Fshatrat të cilat nuk janë të përmendura në paragrafin paraprak të këtij neni, janë të obliguar të zgjedhin këshillat e tyre lokale. Fshatra të tilla janë: Akrashticë, Balincë, Banjskë, Beçiq, Beçuk, Begaj, Bivolak, Brusnik, Dalak, Dobërllukë, Druar, Duboc, Dumnicë e Epërme, Dumnicë e Llugës, Dumnicë e Poshtme, Galicë, Gllavatin, Gojbulë, Gracë, Hercegovë, Kollë, Jezerë, Lumadh, Mavriq, Maxhunaj, Mihaliq, Nedakoc, Novolan, Ashlan, Pantinë, Pasomë, Pestovë, Prelluzhë, Reznik, Ropicë, Sfaraçak i

Epërm, Sfarçak i Poshtëm, Shalë, Shtitatricë, Sllakoc, Sllatinë, Smrekonicë, Stanoc i Epërm, Stanoc i Poshtëm, Stroc, Studime e Poshtme, Tërllobuq, Vërnice, Vilanc, Vushtrri (Dardania dhe Kalaja) dhe Zhilivodë.

Neni 3 Struktura e këshillave lokale

- 3.1. Këshilli i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane mund të ketë prej pesë (5) deri në shtatë (7) anëtarë, përveç rasteve të përmendura në paragrafin 2.2 të kësaj rregulloreje.
- 3.2. Përbërja e këshillave duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor.
- 3.3. Në rast se në një fshat, vendbanim apo lagje urbane jetojnë anëtarë të komuniteteve të ndryshme etnike, përbërja e këshillit duhet të jetë në proporcion me strukturën etnike të tyre.
- 3.4. Këshilli i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane zgjedhet në tubimet e qytetarëve në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me këtë rregullore.
- 3.5. Tubimin publik do ta hapë dhe kryeson deri në zgjedhjen e organeve të reja, kryetari në largim, ndërsa qytetari më i vjetër në raste ku këshilli formohet për herë të parë.
- 3.6. Mandati i këshillit të zgjedhur është katër (4) vjet.
- 3.7. Kryetari i këshillit thërret dhe udhëheq mbledhjet e këshillit dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit. Po ashtu ai i nënshkruan aktet e miratuara nga ana e këshillit dhe është i obliguar në afat prej katërmbëdhjetë (14) ditëve nga dita e miratimit të tyre, t'i dorëzojë në Drejtorinë për Administratë.

Neni 4 Procedura për zgjedhjen dhe shkarkimin e këshillit, kryetarit, zv.kryetarit të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane

- 4.1. Në tubimin publik-zgjedhor, të drejtën për të votuar dhe për t'u votuar e kanë pjesëmarrësit që kanë mbushur moshën 18 vjeçare.
- 4.2. Kryetari në largim i fshatit, vendbanimit, lagjes urbane, propozon formimin e komisionit për organizimin dhe procedimin e mbarëvajtjes së zgjedhjeve të strukturave të reja të këshillit.
- 4.3. Pjesëmarrësit në tubimin publik - zgjedhor nëpërmjet procesit të votimit të fshehtë e zgjedhin këshillin dhe kryetarin. Me pajtimin e pjesëmarrësve të tubimit publik, zgjedhja e këshillit dhe kryetarit mund të bëhet edhe me votim të hapur.
- 4.4. Komisioni për organizimin e procesit të votimit përbëhet prej tre (3) ose pesë (5) anëtarëve dhe i njëjti bën numërimin dhe shpalljen e rezultateve të votimit, duke konfirmuar edhe zgjedhjen e kryetarit të këshillit.
- 4.5. Për kryetar dhe anëtar të këshillit, zgjidhen kandidatët të cilët kanë fituar shumicën e votave, nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në tubimin publik – zgjedhor. Këshilli zgjedh edhe zëvendëskryetarin me mandat të njëjtë.

4.6. Në rastet kur për kryetar të këshillit janë të propozuar më shumë se një kandidat dhe të njëjtit kanë numër të njëjtë të votave, atëherë zhvillohet raundi i dytë i votimit. Kandidati i cili merr shumicën e votave zgjedhet kryetar i këshillit.

4.7. Procesverbali nga takimi publik për zgjedhjen e kryetarit dhe këshillit brenda afatit 3 ditor i dorëzohet Drejtorisë për Administratë.

4.8. Lista finale e kryetarëve të këshillave publikohet në faqen zyrtare të komunës.

4.9. Shkarkimi i kryetarit dhe këshillit bëhet sipas procedurës së njëjtë të zgjedhjes së këshillit.

4.10. Ndërprerja e parakohshme e mandatit të kryetarit dhe këshillit të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane ndodh:

4.10.1. Me paraqitjen e dorëheqjes;

4.10.2. Në rastin e vdekjes;

4.10.3. Në ndërrimin e vendbanimit;

4.10.4. Me iniciimin e mocionit të mosbesimit nga 2/3 e anëtarëve të këshillit.

Neni 5

Kompensimi i kryetarëve të këshillave lokale

Mënyra dhe lartësia e kompensimit për kryetarët e këshillave lokale përcaktohet me vendim nga Kuvendi i komunës, jo më larg se gjashtë (6) muaj nga miratimi i kësaj rregulloreje.

Neni 6

Themelimi i komisionit nga Kuvendi i komunës

6.1. Kuvendi i komunës themelon një komision prej pesë (5) anëtarësh, përfaqësues nga Kuvendi dhe ekzekutivi i komunës (3 nga kuvendi dhe 2 nga ekzekutivi), për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren për zgjedhjen e këshillave.

6.2. Komisioni themelohet me vendim të veçantë të Kuvendit të komunës.

Neni 7

Organizimi i zgjedhjes së kryetarit dhe këshillit lokal

7.1. Drejtorja për Administratë, në bashkëpunim me Zyrën për informim, informon qytetarët në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane për mbajtjen e tubimit publik – zgjedhor, përmes:

7.1.1. Njoftimeve publike në vendet më të frekuentuara;

7.1.2. Medieve lokale, dhe

7.1.3. Faqes zyrtare të komunës.

7.2. Njoftimi i publikut sipas paragrafit 7.1 të kësaj rregulloreje, duhet të përmbajë: datën, kohën, vendin dhe rendin e ditës.

7.3. Procesverbali i hartuar nga tubimi publik-zgjedhor duhet të përmbajë: numrin e pjesëmarrësve, procedurën e votimit, rezultatet e votimit, emrat e anëtarëve të zgjedhur, kryetarit dhe zv.kryetarit, anëtarëve të këshillit, si dhe çështje të tjera të nevojshme.

7.4. Procesverbalin e nënshkruan kryesuesi i tubimit dhe procesmbajtësi, ndërsa komisioni i përcaktuar sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje e informon Drejtorinë për Administratë për rrjedhën e tubimit për zgjedhjen e kryetarit, zv.kryetarit dhe këshillit të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane.

Neni 8 **Kompetencat dhe përgjegjësitë e këshillit**

Këshilli i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si më poshtë:

- a) kujdeset për planifikimin urban dhe rural;
- b) kujdeset për furnizim me ujë, rregullimin e kanalizimit, drenazhimet etj;
- c) kujdeset për ofrimin e shërbimeve publike efikase;
- d) kujdeset që qytetarëve t'ju ofrohet mbrojtja shëndetësore primare;
- e) kujdeset për mbrojtjen lokale të ambientit;
- f) kujdeset për zhvillimin e turizmit;
- g) kujdeset për sigurimin e hapësirave publike dhe varrezave;
- h) kujdeset për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive;
- i) bashkëpunon me organet e komunës dhe organizatat tjera për çështjet me interes për lokalitetin;
- j) evidenton dhe paraqet prioritetet e lokalitetit para organeve të komunës;
- k) merr pjesë në emër të qytetarëve të lokalitetit në financimin e çështjeve që janë pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit me komunën;
- l) kujdeset për organizimin e aksioneve vullnetare në interes për lokalitetin, dhe
- m) kryen edhe detyra tjera konform legjislacionit në fuqi.

Neni 9
Grumbullimi i vetëkontributit

9.1. Në bazë të nevojave dhe të kërkesës së qytetarëve apo me iniciativën e Këshillit mund të organizohet grumbullimi i mjeteve për interes të komunitetit.

9.2. Për çështjen e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, vendimin e merr këshilli lokal.

Neni 10
Bashkëpunimi reciprok në mes të këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane

10.1. Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vushtrrisë, me pëlqimin e tyre mund të organizohen dhe bashkëpunojnë në mes vete për ushtrimin e aktiviteteve të përbashkëta në interes të komuniteteve të tyre.

10.2. Ky bashkëpunim realizohet përmes këshillave lokale.

Neni 11
Zbatimi i Rregullores


Për zbatimin e kësaj Rregulloreje obligohen këshillat e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, kurse monitorimin e saj e realizon Kryetari i komunës përmes Drejtorisë për Administratë.

Neni 12
Dispozita shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja Nr.616/09 e dt.24.09.2009 për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit

